

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trump i thotë Kievit t'i ndalë sulmet ndaj naftës ruse, teksa dronët rusë godasin pranë kufirit polak
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/trump-i-thote-kievit-ti-ndale-et-ndaj-naftes-ruse-teksa-dron-et-ru-i514013
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 07:04:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 06:56:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c40607ea1ccdd44ccefb2c589098a59ab1431cb9fd26c8d3d7f498129a9fa4527
TEKSTI	84a8e6b6b5f06bcd511c7a2a800c89c24e5fa9156998d46de7c5cde7dafa22fd
PAMJA	d89d9308b2d56855000e59f9b7067f9fa078241c298a08b53b6f297e2586e430

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	04f153fa278b9f2c8c08772f6b5aaffeeca4cf3e83802cbaf503c4e0440c1ea8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/04f153fa278b9f2c8c08772f6b5aaffeeca4cf3e83802cbaf503c4e0440c1ea8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

14 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

15 ORE ME PARE

Reforma e re territoriale/ Rama përplasit me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

20 ORE ME PARE

Të shtëna me armë zjarri në Mat/ Gjendet e djegur makina e autorëve, shënjestra ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba

21 ORE ME PARE

"Vetë zot, vetë shkop"/ Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, shpërthen Rama: Do nxirrin dhëmbët për të shumëfishuar rrogat! KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

Bota

Trump i thotë Kievit t'i ndalë sulmet ndaj naftës ruse, teksa dronët rusë godasin pranë kufirit polak

Trump e tha këtë një javë pasi të dërguarit e tij, Steve Witkoff dhe Jared Kushner, e kishin vizituar Kievin dhe Moskën, në përpjekje për t'i afruar kryeqytetet ndërluftuese drejt një marrëveshjeje të negociuar.



14 Shtator 2026, 08:56
Nga E.d



Donald Trump

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i ka bërë thirrje presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, që t'i ndalë sulmet ndaj infrastrukturës ruse të naftës, në një kohë kur Rusia po i vazhdon sulmet e pandërprera në gjithë Ukrainën, përfshirë pranë kufirit me Poloninë.

"Ka plot shënjestra të tjera. Mos e goditni naftën", u tha Trump gazetarëve më 13 shtator gjatë vizitës së tij në Irlandë.

"Duhet t'i ndalni goditjet ndaj naftës në Rusi", tha ai.

Trump e tha këtë një javë pasi të dërguarit e tij, Steve Witkoff dhe Jared Kushner, e kishin vizituar Kievin dhe Moskën, në përpjekje për t'i afruar kryeqytetet ndërluftuese drejt një marrëveshjeje të negociuar.

Derisa të gjitha palët i kanë cilësuar bisedimet si "të rëndësishme", dinamika në vijën e frontit nuk ka ndryshuar. Rusia vazhdon ta sulmojë Ukrainën dhe ta godasë infrastrukturën civile, logjistike dhe energjetike të saj. Ndërkohë, Ukraina ka vazhduar të përgjigjet duke goditur me dronë me reze të gjatë shënjestra energjetike dhe ushtarake brenda Rusisë.

Kievi i ka quajtur këto sulme "sanksione me reze të gjatë", sepse synon t'ia kufizojë Moskës fitimin nga energjia dhe ta detyrojë atë të ulet për të biseduar. Që nga fillimi i verës, sulmet me dronë ukrainas kanë shkaktuar mungesa të karburantit në gjithë Rusinë dhe kanë nxitur pakënaqësi te qytetarët e saj, të cilët ishin shpëputur nga lufta në Ukrainë, që tashmë ka hyrë në vitin e pestë.

Rafineria e naftës e kompanisë ruse Gazprom Neft në Moskë, pranë kryeqytetit rus, u vu në shënjestër të dronëve ukrainas më 18 gershor

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

BOTA 14 SHTATOR 2026, 07:21

Analiza e The Economist: Pse
Rusia po e dobëson qëllimisht
monedhën e saj?

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 07:19

BE ka dhënë 1.1 milionë leje
qëndrimi për shqiptarët, në
Gjermani numri arrin rekordin
e 124 mijë

Ukraina paralajmëron se Rusia "po troket në derën e NATO-s"

Derisa përpjekjet e fundit diplomatike nuk kanë sjellë asnjë ulje praktike të tensioneve në fushëbetejë, dy sulme me dronë rusë goditën pranë kufirit polak në orët e para të 13 shtatorit. Sulmi i parë goditi një pikë karburanti pranë pikëkalimit kufitar Yahodyn, mes Polonisë dhe Ukrainës, në rajonin ukrainas të Volnit. Nuk u raportua për viktima.

Sulmi i dytë, po ashtu në Volin, goditi lokomotivën e një treni pasagjerësh vetëm dy kilometra larg kufirit me Poloninë, njoftoi operatori shtetëror ukrainas i hekurudhave, Ukrzaliznytsia. Sipas Oleksandr Shevchenkos, zyrtar lokal i transportit, treni po udhëtonte nga Kievi drejt Varshavës.

Ukrzaliznytsia tha se një grup që vëzhgon kërcënimet e paralajmëroi paraprakisht ekuipazhin e trenit për sulmin, prandaj nuk pati viktima. Pamjet video të shpërndara në rrjetet sociale ukrainase treguan njerëz duke ikur nga shpërthimi në stacionin hekurudhor.

Ukrzaliznytsia tha se "ka shumë mundësi" që synimi fillestar i sulmit me dron ishte "treni diplomatik", i cili transportonte zyrtarë të lartë evropianë, përfshirë ish-kryeministrin britanik, Boris Johnson.

Kompania shtoi se ish-drejtori i CIA-s, David Petraeus, ndodhej në një tren tjetër në atë kohë. Petraeus i tha gazetës New York Times se kishte dëgjuar dronët rusë mbi vete dhe më pas një shpërthim, gjë që çoi në evakuimin e menjëhershëm të pasagjerëve.

"Për ata që nuk janë përballur me zjarr, kjo ishte e tmerrshme... Ky është veprimi i një udhëheqësi vërtet barbar që po përpiqet të terrorizojë civilët ukrainas", tha Petraeus.

Teksa këto incidente po ndodhnin, alarmet për sulme ajrore u lëshuan në disa zona lindore të Polonisë.

Ndonëse nuk pati raportime për shkelje të hapësirës ajrore polake, Jacek Goryszewski, zëdhënës i Komandës Operative të Forcave të Armatosura të Polonisë, tha se "kërcënimi për Poloninë ishte real". Në incidente të ndara më 13 shtator, autoritetet rumune raportuan se një dron kishte hyrë në territorin e vendit, ndërsa Lituania u bëri thirrje banorëve të kryeqytetit dhe rajoneve përreth që të kërkonin paraprakisht strehim, pasi lëshoi një alarm për një vëzhgim të mundshëm të një droni.

Aeroporti kryesor i vendit në Vilnius u mbyll dhe avionët e NATO-s u ngritën në ajër. Alarmi u anulua brenda një ore.

"Sulmet barbare të Rusisë në kufirin Ukrainë-Poloni, në Yahodyn, nuk janë thjesht vazhdim i sulmeve të saj ndaj kufijve tanë shtetërorë", shkroi ministri i Jashtëm ukrainas, Andriy Sybiha në X më 13 shtator.

"Ky është terrori i Putinit që po 'troket' drejtpërdrejt në dyert e BE-së dhe NATO-s", tha ai.

Ai u bëri thirrje liderëve evropianë që të "hedhin gjithë peshën" e sanksioneve kundër Rusisë./REL

shba

donald trump

Sondazh

Poll

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 07:14

Sa kushton dita e parë e shkollës? Mesatarisht 34 mijë lekë për një fëmijë...

më të klikuarat

"Qepeni gojën" / Debate për shkrirjen e bashkisë, Rama përplaslet me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj! Qytetarët largohen nga takimi

Të shtëna me armë zjarri në drejtëm të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë

Zgjedhjet në Suedi/ E djatha ekstreme synon pushtetin për herë të parë

Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendngjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by  tomorrow.

Bota

14 Shtator 2026, 08:38

"Ne e urrejmë frikën"/ 10 mijë njerëz dalin në rrugë kundër kartelit Sinaloa (VIDEO)

Pamje MEKSIKA- Rreth 10,000 njerëz demonstruan të dielën në Culiacan të Meksikës, duke bërë thirrje për paqe d...

Pas sulmeve në Hormuz dhe mbylljes së tubacionit në Arabinë Saudite, rriten çmimet e naftës

Bota

14 Shtator 2026, 08:32

Zgjedhjet në Berlin mes radikalizimit të politikës

Bota

14 Shtator 2026, 07:53

Droni rus godet trenin e pasagjerëve drejt Varshavë

Bota

14 Shtator 2026, 07:46

Analiza e The Economist: Pse Rusia po e dobëson qëllimisht monedhën e saj?

Bota

14 Shtator 2026, 07:21

Bota

13 Shtator 2026, 22:14

"SHBA nuk mund të mbetet pas Kinës"/ Trump kundër kufizimit të AI: Kush fiton inteligjencën artificiale, fiton mbi të gjithë

Donald Trump SHBA- Presidenti amerikan, Donald Trump ka kritikuar ata që kërkojnë ngadalësimin e zhvillimit të inteligjenc&eu...

VIDEO/ Përfshihet nga zjarri një pyll në Spanjë, plagosen dy persona

Bota

13 Shtator 2026, 20:29

Kthesa strategjike pas përmbytjeve në Marok, synohet që 60% e ujit të pijshëm të sigurohet nga deti

Bota

13 Shtator 2026, 18:32

Krizë ekonomike/ Le Monde: Në Los Anxhelos, mijëra amerikanë detyrohen të jetojnë në makinat e tyre

Bota

13 Shtator 2026, 18:20

Houthit godasin Arabinë Saudite, rritet pasiguria për transportin detar në Detin e Kuq

Bota

13 Shtator 2026, 15:19

MË SHUMË



Aktivisti Arben Kola: Nga nesër mbledhja në sheshin “Skënderbej” nis në orën 18:30

 Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE 

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](#)

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.